



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:189667
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05517003

Ac.nr.10433/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevc, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.A., nga Obiliqi, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.L., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.B., lidhur me çështjen kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditëses dhe ankesës të palës së paditur, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.644/2016 të datës 23.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pathemelta ankesa e paditëses B.A., nga Obiliqi, dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....”, sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.644/2016 të datës 23.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.644/2016 të datës 23.02.2021, në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses B.A., nga Obiliqi, dhe e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “E.....”, me seli në Prishtinë, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 15.02.2016, t’ia paguaj shumat si vijon: në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike, shumen prej 1,900.00 euro; për frikë, shumen prej 1,500.00 euro; për shëmtim trupor, shumën prej 1,600.00 euro; për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 4,200.00 euro. Në emër të dëmit material, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej 300.00 euro;

në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 210.00 euro; në emër të shpenzimeve të shërimit, shumën prej 4,929.00 euro; në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese, dhe atë rentën e arritur për pagesë nga data e aksidentit 15.02.2016 e deri me datën 31.10.2020, në shumën prej 2,944.50 euro, ndërsa për periudhën e ardhshme prej datës 01.11.2020 e tutje, derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë dhe për çdo muaj me së largu deri me datë 05 të çdo muaji vijues, shumën prej 28.69 euro. Në pikën dy e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumat e cekura në pikën I, me kamatën ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 23.02.2021, kur është marrë aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shume prej 2,860.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga ditë marrjes së aktgjykimit. Në pikën tre e ka refuzuar të pabazuar pjesa e kërkesëpadisë e paditëses mbi shumat e gjykuara dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike, në shumën prej 5,600.00 euro, në emër frikës, në shumën prej 5,000.00 euro, në emër të shëmtimit trupor, në shumën prej 5,400.00 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shumën prej 4,800.00 euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, në shumën prej 300.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar, në shumën prej 390.00 euro, në emër të shpenzimeve të shërimit, në shumën prej 5,140.00 euro, emër të fitimit të humbur të arritur për pagesë për periudhën data e aksidentit 15.02.2016 e deri me datën 31.10.2020, në shumën prej 4,418.50 euro, në emër të fitimit të humbur për periudhën e ardhshme prej datës 01.11.2020 e tutje, derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë dhe për çdo muaj, në shumën prej 28.69 euro, ndërsa është refuzuar në tërësi kërkesa për kompensim të dëmit në emër të shërimit klimatik - fizioterapeutik, në shumën prej 1,092.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të së gabuar drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe gjykoj këtë çështje juridike duke aplikuar institutin e përgjegjësisë të ndarë prej 80% të shumave të kërkuara me këtë ankesë dhe me precizim të kërkesëpadisë, në favor të palës paditëse, ashtu që të miratoj kërkesëpadinë e paditëses si në precizimin e lartësisë së saj sa i përket të dhënave ankimore, së bashku me kamatën në lartësi prej 12 %, si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur edhe e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të së gabuar drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështja të kthehet në rigjykim për vendosje në shkallë të parë.

Përgjigje në ankesën e të paditurës ka parashtruar i autorizuari i paditëses, me të cilën ka propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vendoset si në propozim të ankesës nga pala paditëse, e paditura të obligohet në mbulimin e shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në ankesë sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenieve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

- *Ankesa e palës paditëse dhe ankesa e të paditurës janë të pa themelta.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes të autorizuarit të saj me datë 23.03.2016, ka parashtruar padi ne gjykatën e shkallës së parë, kundër te paditurës për kompensimin e dëmit jo material dhe material, si në parashtresën e precizuar, duke theksuar se me datë 15.02.2016, rreth orës 10:30 h, në rrugën Prishtinë-Obiliq, gjegjësisht në fshatin S....., është shkaktuar aksident trafiku, ku si pasojë e këtij aksidenti paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore. Ka shtuar së në bazë të raportit të aksidentit, skicës së vendit të ngjarjes, ekspertizës së komunikacionit rrugor të nxjerr nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, ekspertizës së komunikacionit rrugor dhe super ekspertizës së komunikacionit rrugor të nxjerra në këtë çështje, shihet qartë së shkaktar primar i këtij aksidenti është i siguruari i të paditurës, e cila nga pakujdesia duke mos ju përshtatur shpejtësisë së lëvizjes, kushteve dhe rrethanave në rrugë, dhe duke hyrë në kryqëzim me shpejtësi të madhe, e ka goditur këmbësoren B.A., e cila në momentin e goditjes ishte duke kaluar rrugën nga ana e djathtë në të majtë, ndërsa lëshime kontribuuese ka edhe vet këmbësorja, këtu paditësja, sepse ka bërë kalim të pasigurt të rrugës. Duke marrë për bazë rrethanat e rastit dhe vendi ku ka ndodhur aksidenti, ka kërkuar nga gjykata që me rastin e vendosjes të aplikoj institutin e përgjegjësisë së ndarë 80% me 20%, në favor të palës paditëse, pasi që super ekspertiza e komunikacionit rrugor nuk ka marrë për bazë nenin 64, 147 dhe 146 par. 2 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugorë.

Duke vepruar sipas kësaj padie, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, mes tjerash gjykata e shkallës së parë ka theksuar se bazën e kërkesëpadisë e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës së komunikacionit të hartuar nga grupi i eksperteve Ing. B.L., Ing. S.SH., dhe Ing. RR.S., grupi i ekspertëve ka ardhur në përfundim së deri të aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur për shkak të lëshimeve të dy pjesëmarrësve në këtë aksident, dhe atë ngasësi i automjetit "A" (L.... R.....), nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në raport me rrethanat e krijuara në rrugë - para mjetit të saj në lëvizje, duke e goditë këmbësoren B.A., e cila në ato momente po e kalonte rrugën nga ana e djathtë në të majtë para mjetit të saj. Ndërsa këmbësorja ka bërë kalim të pasigurt të rrugës (drejtpërdrejtë para mjetit në lëvizje) duke mos verifikuar me parë prezencën e mjeteve në rrugë, në momentin kur në afërsi të saj në anën e majtë të rrugës ishte duke lëvizur automjeti "A" në shiritin e djathtë të rrugës, dhe i cili kishte përparësi kalimi në raport me këmbësoren. Mbi këtë bazë gjykata ka ardhur në përfundim se e paditura mbanë përgjegjësi të ndarë në shkaktimin e dëmit në shkallën prej 50%, pasi që deri te ky aksident i komunikacionit rrugor ka ardhur si shkak i lëshimeve të dy pjesëmarrësve në këtë aksident dhe këmbësore-paditëses e cila ka bërë kalim të pasigurt të rrugës, dhe në këtë rast paditësja mban përgjegjësi në shkaktimin e dëmit në shkallën prej 50%. Ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës mjekësore të datës 28.01.2020 dhe duke marrë për baze dispozitën e nenit 200 te LMD-së, andaj e ka obliguar të paditurën qe shumat e gjykuara si ne parag. I pika A) te dispozitivit që paditëses ne mënyrë proporcionale me kontributin t'ia kompensojnë dëmin jo material, ndërsa bazë për

dëmshtëpërblimin e dëmit material kanë qenë nenet 136 dhe 176 të LMD-së, ndaj e ka detyruar të paditurën që shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, t'ia kompensojë paditëses në mënyrë të përpjesëtuar sipas kontributit. Kompensimin e rentës në të holla në formë të kapitalizuar si forme e kompenzimit të dëmit material të gjykuar si në paragraf 1 pikë B) të dispozitivit, gjykata e ka bazuar në nenin 173 paragraf 1 të LMD-së, për periudhën kohore nga dt.15.02.2016 kur është shkaktuar aksidenti-lëndimi paditësit e deri me dt.31.10.2020, ndërsa për periudhën e ardhshme prej datës 01.11.2020, e deri sa ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë dhe për çdo muaj e deri me datë 05 të çdo muaji vijues, gjykata me rastin e caktimit të lartësisë të këtij lloji kompensimi material e ka bazuar në ekspertizën e ekspertit të punës, i cili ka përcaktuar shkallën e pa aftësisë punuese të paditëses, e që pastaj në bazë të kësaj ekspertize, eksperti financiar ka bërë përlllogaritjen për periudhën e kaluar prej aksidentit e deri me datën e përpilimit të ekspertizës, kamatën si dhe periudhën e ardhshme e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore por jo më gjatë se data 12.02.2025 kur me ekzaminim mjekësor duhet rivlerësuar invaliditeti i punës, atë të kapitalizuar, si dhe shpenzimet e trajtimit mjekësor. Për bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata i është referuar nenit 136, 137, 159, 173, 176, 179, 174, 183 par.1 të LMD-së. Vendimin lidhur me kamatën e ka marrë konform nenit 382 të LMD-së. Ndërsa për shpenzimet e procedurës, i është referuar dispozitës së nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pikë (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqës për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve tjera nga neni 182.2 të LPK-së, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhmëni me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për bazën juridike të kërkesëpadisë dhe shumën e aprovuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, ku me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, aktgjykimin e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që i referohen çështjes e cila është objekt i këtij kontesti në rastin

konkret. Me dispozitën 136, paragrafi 1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa bazën e kërkesëpadisë së paditëses gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar nga grupi i eksperteve, i cili ka ardhur në përfundim së deri të aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur për shkak të lëshimeve të dy pjesëmarrësve në këtë aksident, mbi këtë bazë gjykata ka ardhur në përfundim se e paditura mban përgjegjësi të ndarë në shkaktimin e dëmit në shkallen prej 50%, dhe në këtë rast paditësja mban përgjegjësi në shkaktimin e dëmit në shkallën prej 50%, andaj në rastin konkret me të drejtë ka aplikuar dispozitën e nenit 176 paragrafi 1 i LMD-së, i cili ka paraparë se: *“I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar”*, atëherë edhe gjykata e shkallës së dytë të njëjtit i konsideroi si përgjegjës për shkaktimin e dëmit i cili dëm është vërtetuar dhe me rastin e caktimit të lartësisë së tij, në mënyrë të drejtë është përpjesëtuar sipas kontributit të secilit pjesëmarrës në aksidentin e komunikacionit të datës 15.02.2016, dhe e obligoi të paditurën që këtë dëm t’ia kompensoj paditëses.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditëses, i ka vërtetuar shumat e kompensimit të aprovuara në pjesën e parë të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ndërsa ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e palës së paditur, sipas së cilës, shumat e kompensimit do të duhej të uleshin, për të përmbushur qëllimin e satisfacionit adekuat material për palët e dëmtuara. Në anën tjetër është refuzuar edhe ankesa e palës paditëse me të cilën është atakuar pika I dhe III e dispozitivit të atakuar, ku e njëjta ka pretenduar që shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit janë shumë të ulëta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të rënda trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore, ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183 par.2 të LMD-së, (Ligji Nr. 04/L-077) i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intesitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompesimi të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast palët paditëse kanë pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfacion të vërtet, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe mbi shumën në emër të dëmit material, për ushqim të përforcuar, ndihmë të personit të tretë meqë, siç theksohet edhe në ekspertiza mjekësore, paditësit kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar për 2 (dy) muaj, të pasur me vitamina, proteina dhe albumina dhe ndihmë të personit të tretë për 2 (dy) muaj. Edhe pse një formë e tillë e dëmit është më e vështirë për t’u vërtetuar me prova konkrete, praktika e

Gjykatave të Kosovës e njeh kompensimin e dëmit të tillë, e meqenëse është konstatuar nevoja për ushqim të përforcuar, atëherë rrjedhimisht e ligjërisht, paditëses i takon kompensimi për të. Gjithashtu është vërtetuar edhe shuma e gjykuar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit në emër të dëmit material për shpenzime të shërimit, pasi që referuar shkresave të lëndës rezulton se palët paditëse i kanë ofruar gjykatës së shkallës së parë prova përkatëse materiale (fatura) të cilat dëshmojnë lartësinë e këtyre shpenzimeve, të cilat janë përlllogaritur edhe me ekspertizën e aktuaristikës dhe financave të përpiluar nga eksperti Aziz Berisha, i cili ka bërë llogaritjen e shpenzimeve të shërimit sipas faturave - kuponëve fiskal të cilat kanë qenë në shkresat e lëndës dhe ka konstatuar së dëmi material në emër të shpenzimeve të shërimit është në vlerë prej 9,858.00, që pastaj kjo vlerë është përpjesëtuar sipas kontributit të pjesëmarrësve në aksident.

Kolegji i kësaj gjykate ka pranuar në tërësi pjesën e aktgjykimit përkitazi me fitimin e humbur dhe se në këtë pjesë pretendimet ankimore të paditurës nuk qëndrojnë, sepse gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka caktuar ekspertizën nga lëmia e punës dhe e njëjta është e përpiluar konform standardeve shkencore dhe në bazë të gjendjes faktike nga eksperti i mjekësisë së punës Dr. XH.SH., i cili në ekspertizën e datës 12.02.2020, ka konstatuar se zvogëlimi i aftësisë së përgjithshme të punës së paditëses është 16.25%, kjo për shkak të zvogëlimit të lëvizshmërisë së nyjës së gjurit të majtë, krahasuar me gjurin e shëndosh deri në 1/3 e lëvizjeve në gju, zvogëlimit të lëvizshmërisë së dorës në nyjën e bërrylit, krahasuar me dorën e shëndosh deri 1/3 e lëvizjes së dorës, dhe gjendjes pas hemoragjisë subarahnoidale të kokës në regjionin parietal në anën e djathtë, andaj kolegji ka gjetur se gjykata e shkallës së parë përkitazi me dëmin material në formë të fitimit të humbur, të cilën pas kësaj ekspertize lartësinë e kësaj forme të dëmit e ka përlllogaritur eksperti i aktuaristikës dhe i financave A.B., i cili ka llogaritur fitimin e humbur nga data e shkaktimit të aksidentit deri në datën e përpilimit të ekspertizës, periudhën e ardhshme prej datës 01.11.2020 e tutje, deri sa për këtë të ekzistojnë kushte ligjore, por jo dhe pas datës 12.02.2025 në formë të fitimit të humbur – rentës, duke marrë për bazë të ardhurat mesatare të të punësuarave femra me përgatitje të mesme shkollore në Kosovë, dhe fitimin e humbur për periudhën kontestuese e ka llogaritur në proporcion me invaliditetin e saj të punës, ndërsa gjykata e ka gjykuar atë në proporcion me kontributin në shkaktimin e aksidentit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 173 par.1, lidhur me nenin 189 të LMD-së.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitivin e nenit 382 të LMD-së. Gjithashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura si më lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të neneve 194, 195 paragrafi 1 pika, c) dhe d), lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10433/2021, me datë 14.03.2024

Kryetare e kolegjit,
Naime Ahmeti, d.v.